

Nr.	APLIKIMI	Dokumentacioni
1.	<p>a) Aplikimi duhet të dorëzohet nëpërmjet një kërkesë me shkrim i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar.</p> <p>b) Dokumentacioni shoqëruar duhet të jetë në original ose fotokopje të njehsuar me originalin, si dhe të jenë në gjuhën shqipe</p> <p>c) Aktet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.</p> <p>ç) I gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet në 2(dy) kopje; nga të cilat njëra duhet të jetë origjinale dhe 1(një) fotokopje, përtej duhet të jetë i gjithë materiali i të skanuar në formatin pdf (të emëruar sipas pikave në këtë dokument).</p> <p>d) Dokumentet që vërtetojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin e lojërave të fatit dhe në këtë vendim duhet të jenë lëshuar/miratuar nga organet përkatëse, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e aplikimit.</p> <p><i>Baza ligjore: V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 kreu V pika 1, pika 2, dhe kreu III pika 4/g.</i></p>	

2.	KUSHTET DHE KËRKESAT TEKNIKE	
	Dokumentacioni	
2.1	<p>a) Të plotësoj kushtin e çertifikimit/ klasifikimit me 5 yje nga institucionet përgjegjëse</p> <p>- "...lejohet zhvillimi i aktivitetit të lojërave të fatit përkatësinë "Kazino" në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me kusht që të jenë të vendosura në hotelet e certifikuar me 5 yje nga institucionet përgjegjëse dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Një hotel i klasifikuar sipas institucioneve përgjegjëse klasifikohet automatikisht si subjekt që mund të marrë licencë kazinoje." (Baza ligjore: Neni 35, pika 2 Ligj 155/5015)</p> <p>- "Hotele me 5 yje" janë hotelet, të cilat kanë marrë certifikatën e akreditimit për këtë klasifikim nga institucionet ndërkombëtare akredituese dhe që janë mbajtëse të një marke tregtare të regjistruar, të certifikuar dhe të njohur ndërkombëtarisht "brand name".</p> <p>(Baza ligjore: Neni 4 pika 13 Ligj 155/5015)</p>	<p>1. Dokument që vërteton certifikim / klasifikimin si "Strukturë akomoduese me 5 yje"</p> <p>2. Të paraqes kontratën me brandin ndërkombëtar të certifikuar / klasifikuar për kategorinë hotel me 5 yje, "brand name" (sipas nenit 4, pikes 13 ligji 155/2015), bashkë me certifikatën e lëshuar nga strukturat përgjegjëse ndërkombëtare.</p>
2.2	<p>a) Të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në objektin e veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet</p>	<p>1. Kopje të noterizuar të certifikatës së regjistrimit me numrin unik të identifikimit të aplikuesit</p> <p>2. Ekstrakt i thjeshtë QKB</p> <p>3. Ekstrakt historik QKB</p>

	<p>b) Shuma e kapitalit duhet të jetë jo më pak se 1,200,000,000 lek.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “a” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/a, 2/a</p>	
2.3	<p>a) Të deklarohet burimi i kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e “Kazinosë”.</p> <p>b) Aplikuesi dhe aksionarët duhet të paraqesin dokumentacion për të vërtetuar origjinën e kapitaleve të tyre, të cilat do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “c” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/c dhe 2/d</p>	<p>1. Deklaratë dhe dokumentacion provues mbi shumën e kapitalit që do të investohet (sipas biznes planit të paraqitur), dhe mbi burimin e këtij kapitali.</p> <p>2. Raport se si do behet investimi ne raport me partnere:</p> <p>a. Nëse është individ, divën për paktwn 3 vitet e fundit</p> <p>b. Nëse është shoqeri tregtare bilancin e kompanive të paktwn 3 viteve të fundit.</p>
2.4	<p>a) Dokumentacion mbi përvojën në fushën e lojërave e fatit.</p> <p>b) Aplikuesi ose, të paktën, njëri prej aksionarëve të aplikuesit, që ka përvojë në fushën e lojërave të fatit, paraqet një listë të veprimtarive në fushën e lojërave të fatit, të shoqëruar me autorizimet, miratimet, licencat apo lejet, në bazë të të cilave i ushtron këto veprimtari.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “ç” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/ç dhe 2/ç.</p>	<p>1. Autorizime / miratime / licenca / leje, në bazë të cilave ushtron këto veprimtari.</p> <p>2. Informacion të detajuar të aplikuesit apo njërit nga aksionerëve që ka eksperiencen në fushën e lojrave të fatit</p>
2.5	<p>Dokumentacion për kapacitetet e duhura financiare, administruese, organizative dhe besueshmërinë e aplikantit për t’u angazhuar me sukses në projekte të tilla.</p>	<p>1. Plan biznesi i detajuar (për të paktën 3 vitet e ardhëshme të aktivitetit).</p> <p>2. Bilancet e 3 viteve të fundit të aplikuesit dhe të aksionerëve që janë person juridik.</p> <p>3. Deklaratë për fuqinë mesatare punëtore dhe për numrin e stafit drejtues.</p>

	<p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “d” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/d, dhe Kreu IV, pika 1/a.</p>	<p>4. Informacion për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion të aplikuesit, për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga licenca.</p> <p>5. Informacion dhe të dhëna teknike për pajisjet elektronike që përdoren apo do të përdoren nga aplikanti, të cilat duhet të jenë në përputhje me standartet ndërkombëtare.</p>
2.6	<p>a) Të paraqesë garancinë pasurore, së bashku me aplikimin dhe me kushtet e sekuestrimit të kësaj garancie</p> <p>b) Vërtetim nga një institucion bankar, për të garantuar se subjekti ka kapacitetet e duhura financiare për të përmbushur detyrimet e garancisë pasurore, në favor të ministrisë përgjegjëse për financat dhe AMLF-së, në përputhje me nenet 19, pika 3, shkronja “ç”, dhe 47, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “dh” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/dh dhe 2/dh.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vërtetim nga një institucion bankar për krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit në një llogari të veçantë bankare, në favor të Ministrisë së Financave, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit të Financave. 2. Vërtetim nga një institucion bankar për krijimin e garancive për shlyerjen e detyrimeve periodike karshi AMLF-së në një llogari të veçantë bankare, në favor të AMLF-së, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit të Financave 3. Vërtetim nga një institucion bankar që garanton kapacitetet e duhura financiare nga ana e subjektit lidhur me tarifën e licensimit.
2.7	<p>Kufizimet për ndryshimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “e” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/e dhe 2/b.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Statuti i shoqërisë dhe / ose akti i themelimit ku të specifikohen kufizimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit me miratim të AMLF.

2.8	<p>a) Ngritja e serverit (dokumentacion teknik dhe përshkrimi i serverit)</p> <p>b) Subjekti aplikues duhet të paraqesë pranë AMLF-së dokumente që i provojnë se pajisjet që do të përdorë për zhvillimin e lojërave në kazino janë të standardeve të kërkuara, sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/5 pika “ë” dhe V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu I pika “ë” dhe Kreu IV pika 3,4,5 dhe 6.</p>	<p>1. Subjekti aplikues duhet të dorëzojë listën e deklaratave, në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Software-in që përdor apo propozohen të përdoren - Modele të licencave dhe certifikatave SSL që përdor apo propozohen të përdoren; - çdo standard apo certifikim të njohur ndërkombëtarisht ISO 9001, 27001 etj. - Subjekti aplikues duhet të paraqesë pranë AMLF-së dokumente që i provojnë se pajisjet që do të përdorë për zhvillimin e lojërave në kazino janë të standardeve të kërkuara, sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
3	DOKUMENTACION I SHOQËRIS DHE AKSIONERËT	
3.1	<p>Aksioneret e shoqërisë nëse janë persona juridik:</p> <p>a) Dokumente shkresore për të provuar të dhëna për aksionaret e shoqërisë dhe pronarët përfitues</p> <p>b) Të dhëna për organet drejtuese të aplikantit dhe përfaqësuesin ligjor</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/5015 neni 36/6 pika “a”, “b”, V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 2/e.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktet e themelimit dhe statutet e tyre, së bashku me certifikatën, nga organi që mban regjistrin tregtar në vend apo jashtë vendit, ku të jenë të evidentuar emrat e pronarëve përfitues dhe përqindja që ata zotërojnë në kompani. 2. Ekstrakt historik regjistrimit të pronarit përfitues nga organet përgjegjëse 3. Emrat e anëtarëve të organeve drejtuese (administratorit/ve, këshilli mbikëqyres/administrimi) 4. Të dhëna të tjera për organet drejtuese të tyre, në rast se kërkohet nga Autoriteti 5. Emrat e aksionerve që zotërojnë të drejta të vecanta.
3.2	<p>a) Të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit, për 3</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bilancet për tre vitet e fundit të biznesit të aksionarëve

	<p>vitet e fundit, përpara paraqitjes së kërkesës</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligji 155/5015 neni 36/6 pika “c”, V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 3/ç..</p>	<p>a) Nëse është individ, divën për 3 vitet e fundit</p> <p>b) Nëse është shoqëri tregtare bilancin e kompanive të 3 viteve të fundit.</p>
3.3	<p>Dokumente për aksionarët e shoqërisë dhe të përfaqësuesit të saj,</p> <p>a) Informacion për organet drejtuese</p> <p>b) Dokumente ku të vërtetohet se subjekti aplikant është me status aktiv.</p> <p>c) Dokumente ku të vërtetohet se subjekti aplikant është i padënuar penalisht.</p> <p>d) Vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi.</p> <p>e) Vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për subjektin:</p> <p>1.Subjekti nuk është në ndjekje penale</p> <p>2.Subjekti nuk është në gjykim për vepra penale</p> <p>3.Subjekti nuk është dënuar penalisht</p> <p>4. Zyra e përmbartimit Gjyqësor, se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligji 155/5015 neni 36/6 pika “ç”, “d” V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 3/d..</p>	<p>1. Fotokopje të dokumentit identifikues</p> <p>2. Informacion për organet drejtuese të shoqërisë.</p> <p>3. Vërtetim për statusin aktiv / pasiv nga Drejtoria e Tatimeve.</p> <p>4. Vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi.</p> <p>5. Dëshmi penalisht për administratorët, këshillin e administrimit/ mbikqyrës dhe aksionarët.</p> <p>6. Vërtetim që subjekti nuk është në ndjekje penale</p> <p>7. Vërtetim që subjekti nuk është në gjykim për vepra penale</p> <p>8. Vërtetim që subjekti nuk është i dënuar penalisht</p> <p>9. Vërtetim nga zyra e përmbartimit gjyqësor, që subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera</p>

3.4	<p>Nëse aksionarët e subjektit aplikues janë individë, ata duhet të paraqesin:</p> <p>a) Dëshmi penaliteti të dorëzuar nga aplikantët /administratorët dhe ortakët e shoqërisë dhe pronarët përfitues në momentin e aplikimit.</p> <p>b) Vërtetim që nuk janë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale.</p> <p>c) Vërtetim se individit nuk është në proces gjyqësor për vepra penale.</p> <p>d) Vërtetim nga shërbimi përmbartimor, që nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/2015 neni 36/6 pika “ç”, ”d” V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 3/a, 3/b dhe 3/c,4/a</p>	<p>1) Dokument identifikimi</p> <p>2) Dëshmi penaliteti</p> <p>3) Vërtetim nga gjykata, që nuk është në proces gjyqësor penal,</p> <p>4) Vërtetim nga prokuroria, që nuk është në procedim penal</p> <p>5) Vërtetim nga shërbimi përmbartimor, që nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.</p> <p>6) Vërtetim nga Struktura e Posacme Kunder Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar SPAK që nuk është në procedim penal.</p>
3.5	<p>Marrëveshje paraprake, të paktën me njërin nga bankat e nivelit të dytë, me seli në territorin e Republikën e Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/b.</p>	<p>Vërtetim / marrëveshje paraprake që mund të hapi apo të ketë llogari në një nga bankat e nivelit të dytë apo institucionet financiare në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>
3.6	<p>Fondin e lojtarit dhe fondin e garancisë të depozituar në favor të AMLF-së</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligj 155/2015 neni 36/6 pika “e”, neni 36/5 pika “dh”, V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 1/dh.</p>	<p>Dokumentacioni i pikes 1 dhe 2 tek rreshti 2.6 i kësaj tablele</p>
3.7	<p>Deklaratë që subjekti aplikues nuk ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë</p>	<p>Deklaratë</p>

	<p>qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë, anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit, pronar përfitues apo persona të lidhur që rezultojnë të dënuar penalisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë për veprat penale të parashikuara në ligj.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> Ligji 155/2015 neni 36/6 pika “f”, V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/ë</p>	
3.8	<p>Projekt-rregulloren e lojës, të hartuar sipas kërkesave të nenit 38, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/f.</p>	<p>Projekt-rregulloren e lojës e cila duhet të përmbajë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin 155/2015 dhe sipas VKM 690 date 02/09/2020 dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.</p>
3.9	<p>Aplikuesi duhet të paraqesë një vetëdeklarim se nuk është në ndjekje penale, si dhe një dokument që vërteton se subjekti aplikues ka shlyer: a) detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore; b) të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/ç.</p>	<p>-Deklaratë që nuk është në ndjekje penale -Vërtetim nga administrata tatimore që nuk ka detyrime -Vërtetim për detyrimet për sigurimet shoqërore nga administrata tatimore</p>
3.10	<p>Deklaratë e subjektit aplikues, me anë të së cilës subjekti merr përsipër dhe garanton vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura në dosje</p>	<p>Deklaratë</p>

	<i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/d.	
3.11	<p>Deklaratë që subjekti aplikues nuk rezulton debitor ndaj institucioneve shtetërore dhe ka shlyer detyrimet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/dh.</p>	Deklaratë
3.12	<p>Deklaratë se subjekti aplikues nuk ka në përbërjen e tij ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit që rezultojnë debitorë ndaj institucioneve shtetërore</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/e</p>	Deklaratë
3.13	<p>Deklaratë që subjekti aplikues nuk ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit, që rezultojnë të dënuar penalisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprat penale të parashikuara në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p><i>Baza ligjore:</i></p>	Deklaratë

	V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 4/ë.	
3.14	<p>Autorizim nga aplikuesi, që autorizon AMLF për të bërë, pa asnjë kufizim, verifikimin e dokumentacionit dhe/ose të informacionit të dhënë në aplikim. Dështimi i aplikuesit për të dhënë një autorizim të tillë sjell refuzimin e aplikimit.</p> <p><i>Baza ligjore:</i> V.K.M. Nr. 690, datë 2.9.2020 Kreu III pika 5.</p>	Autorizim nga aplikuesi, që autorizon AMLF për të bërë, pa asnjë kufizim verifikimin e dokumentacionit dhe/ose të informacionit të dhënë në aplikim

AMLF: përveç sa më lart, rezervon të drejtën të kërkojë çdo informacion tjetër, të cilin e gjykon të nevojshëm t'ia kërkojë aplikantit për fushën e veprimtarisë që do të ushtrohet.